



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancim në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, shpall:

Konkurs i Brendshëm - Avancim

Për plotësimin vendit të lirë të punës: Një (1) pozitë.

Titulli i postit: Menaxher/e i Personelit .

Marrëdhënia e Punës : Në bazë të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Kosovës dhe akteve tjera normative, të cilat rregullojnë punësimin në SHCRK.

Koeficienti: Nëntë (9)

Numri i referencës së vendit të punës: PE/010 JP00037101

Përgjegjësi mbikëqyrëse: Po

I raporton: Sekretarit të Përgjithshëm në Sekretarinë e KPMSHCK

Orari i plotë i punës: PO

Vendi: Prishtinë

Qëllimi i Punës dhe rezultatet: Sigurimi i zbatimit të procedurave ligjore për menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

- 1.Udhëheqë punën e burimeve njerëzore dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
2. Ndihmon mbikëqyrësin në vlerësimin e proceseve dhe procedurave të brendshme dhe rekomandon ndryshime/përmirësime me qëllim të ngritjes së efikasitetit në punë;
3. Siguron zbatimin e legjislacionit ligjore lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimet njerëzore;
- 4.Është përgjegjës për sigurimin e mbarëvajtjes së procedurave të rekrutimit të nëpunësve civil, përgatitë konkurset, akt emërimet, kontratat për marrëdhënien e punës, procedon pagat dhe bën mirëmbajtjen e dosjeve të personelit;

5. Këshillon dhe mbështet udhëheqësit e njësive organizative të institucionit lidhur me përshkrimet adekuate të vendeve të punës, vlerësimin e punës së personelit në zhvillimin e karrierës dhe ngritjes profesionale;
6. Mbështet punën e Komisionit për ankesa dhe parashtresa dhe Komisionit disiplinor;
7. Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara.

Kualifikimi, aftësimi dhe përvoja:

1. Diplomë universitare nga fakulteti juridik, ekonomik dhe administrate publike, dhe 5 vite përvojë pune profesionale;
2. Njohuri dhe përvojë substanciale në fushën e burimeve njerëzore;
3. Aftësi komunikuese, negociuese dhe bindëse në menaxhim;
4. Shkathtësi në caktim të objektivave, planifikim të punës dhe analizë;
5. Shkathtësi në udhëheqje dhe organizim të ekipit, aftësi për të menaxhuar një ekip ose grup punues;
6. Shkathtësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në ndërtesën e Ish-Gërmisë, në Sekretariati i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Zyra C- 214. Për informata më të hollësishme, mund të kontaktoni personelin në tel. 038.211-673 prej orës 08:00 deri në ora 16:00.

Konkursi ngel i hapur tetë (8) ditë nga dita e publikimit në web-faqen e Këshillit dhe në tabelën e shpalljeve në KPMSHCK, duke filluar nga data 21.12.2018 deri më datën 28.12.2018, që konsiderohet si ditë e fundit të mbylljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë. Kandidatët të cilën hynë në përzgjedhje të ngushtë për intervistë, do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Personeli.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga personeli dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues.

“Shërbimi Civil i Kosovës u shërben të gjithë banorëve të Kosovës dhe mirëpret aplikimet nga femrat dhe meshkujt e të gjitha komuniteteve të Kosovës”.